



01 Nr. 476/25 Dt. 01.08.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik i plotësuar me rregulloren 002/2004 për prokurim publik dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së menaxherit të kontratës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e ndryshimeve në projekt

1. Miratohet kërkesa e menaxherit të kontratës, për lejimin e ndryshimeve të pozicioneve (kolaudim të kontratës) në projektin: “Ndërtimi i strehimores për qenët endacak në Komunën e Prizrenit”, i cili është duke u realizuar nga OE “ALBOSS” shpk, konform kontratës, nr. të prokurimit 622-23-14027-5-2-1.
2. Obligohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sektori i Prokurimit, OE “ALBOSS” shpk dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - OE “ALBOSS” shpk,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.

